



Në bazë të nenit 35 alineja 3 nga Ligji për planifikim hapsinor dhe urbanistik (F;/zyrtare e RM nr.199/14, 44/15), neni 50 pika 4 nga Ligji për administrim lokal („Fl.zyrtare e RM,, nr. 5/02), neni 22 nga Statuti i Komunës së Likovës, dhe Ndrimi dhe plotësimi i Programit vjetor për punimin e planeve urbanistike të Komunës së Likovës për vitin 2019, me Vendim nr. 08-447/18 nga 14.05.2019, nga Këshilli komunal i komunës së Likovës, Kryetari i komunës së Likovës, jep

LAJMËRIM

**Për organizimin e prezentimit publik dhe anketës publike
për DPLU për njësi të mëdha hoteljrike (B3) në pjesën e PK. nr.15/1 KK Sllupçan-K. e Likovës**

Kufijtë e përfshirjes janë: një pjese të PK. 15/1 KK Sllupçan – Komuna e Likovës

Përfshirja është sipërfaqe prej 2,18 ha.

Anketa publike dhe prezentimi publik për propozim programin e Kryetarit të Komunës, do të zbatohet me ekspozimin e Propozim Planit në hapësirat e sallës të Këshillit të Komunës së Likovës.

Anketa Publike do të zgjatë 7 ditë pune nga dita e shpalljes të Lajmërimit, çdo ditë pune nga ora 10,00 deri 15,00.

Në afatin e përmendur, qytetarët e interesur dhe personat juridik nga rajoni konkret të përfshirë me planin mund të dorëzojnë vërtetje me shkrim, propozime dhe mendime në listat anketuese.

Prezentimi publik me prezentimin profesional të planit do të mbahet më dt.24.07.2019 në ora 10,30 në hapësirat e sallës së Këshillit të Komunës së Likovës.

Punoi, Dije Arifi
Kontrolloi, Feim Selmani,
Aprovoi, Nexhadi Osmani

Komuna e Likovës
Kryetar,
Erkan Arifi